



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.9/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtarë dhe me zyrtaren e lartë lart ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga kandidatja e subjekti politik Partija Kosovskih Srba (PKS), Biljana Popoviq me seli në Leposaviq, paraqitur kundër vendimit me nr.717/2017 të dt.24.05.2017 të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 26.05.2017, mori këtë:

#### VENDIM

**I. PRANOHET** apeli si i bazuar i Biljana Popoviq, lidhur me tërheqjen nga lista e kandidatit për deputet nga Partija Kosovskih Srba (PKS), Leposaviq.

**II. ANULOHET** vendimi nr.717/2017 i Komisionit Qendror i Zgjedhjeve lidhur me certifikimin e kandidates Biljana Popoviq.

#### Arsyetim

Parashtruesja e apelit, Biljana Popoviq, kandidate për deputete e Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik, Partija Kosovskih Srba (PKS) me seli në Leposaviq me datën 25.05.2017, ka paraqitur apel në PZAP, kundër vendimit të KQZ-së me nr.717-2017 për certifikimin e kandidatëve të datës 24.05.2017, në të cilin kërkon që të tërhiqet nga lista e kandidatëve për deputet për shkak të arsyeve të saja personale dhe nuk mund të jetë në listën e kandidatëve për deputet. Parashtruesja e apelit pretendoi se ka njoftuar edhe subjektin e saj politik PKS dhe se emri i saj në këtë listë është kundër vullnetit të saj. Po ashtu nëpërmjet kësaj shkrese dëshmon se nuk ka pranuar vullnetarisht që të jetë në këtë listë. Parashtruesja e apelit kërkon nga PZAP-i që ti merret për bazë kërkesa për tërheqja nga lista e kandidatëve dhe të anulohet vendimi i KQZ-së

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi KQZ-në më datën 25.05.2017, për apelin që është bërë ndaj vendimit të KQZ-së dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj apelit në të njëjtën ditë.

PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga KQZ brenda afatit të caktuar me të cilën theksohet se në bazë të nenit 28.1 të LZP-së tërheqja apo zëvendësimi i kandidatëve dhe subjekteve politike mund të tërhiqet nga procesi zgjedhor duke i dorëzuar KQZ-së një njoftim me shkrim për tërheqje jo më vonë se dy ditë të punës para datës së caktuar për tërheqjen e shortit të përcaktuar sipas nenit 24.1 të LZP-së. Në vazhdim të përgjigjes theksohet se KQZ në mbledhjen e mbajtur me datën 24.05.2017 ka marrë vendim me nr. Protokollit 717-2017 ku është caktuar që data e hedhjes së shortit të bëhet me datën 26.05.2017 ku sipas KQZ-së parashtruesja e apelit kërkesën për tërheqje ka parashtruar më datën 25.05.2017 dhe bazuar në nenin 28.1 të LZP-së e njëjta nuk mund të tërhiqet nga procesi zgjedhor.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

#### **Apeli është i bazuar:**

Tërheqja e një kandidati nga listat e kandidatëve nga një subjekt politik ose nga vet kandidati është e rregulluar me LZP konkretisht me nenin 28.1 të LZP-së, ku përcaktohet se: “subjekti politik i certifikuar mund të tërhiqet nga procesi zgjedhor duke i dorëzuar kërkesën KQZ-së, për tërheqje jo më vonë se dy (2) ditë të punës para datës së caktuar për hedhje të shortit”, ku sipas kësaj dispozite apeli i parashtruar nga ana e kandidates Biljana Popoviq është paraqitur brenda afatit kohorë dhe se ndryshimi i datës së hedhjes së shortit nga ana e KQZ-së, nuk mund të jetë në dëm të kandidates.

Paneli konstatoi se apeli është i bazuar pasi që neni 122.1 pika c, i LPZ-së, përcakton se nëse kandidati pas certifikimit nuk dëshiron të marrë pjesë në procesin zgjedhor mund të parashtrtoj apel në PZAP, andaj mbi këtë bazë paneli konstaton se apeli është i bazuar duke marrë parasysh se kandidates për deputete Biljana Popoviq, e cila për arsye personale nuk dëshiron që të jetë pjesë në listat zgjedhore në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Andaj mbi këtë bazë dhe bazuar në nenin 122.1 pika c si dhe nenin 118.1 të LPZ, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr.09/2017 më datën 26.05.2017.



**Këshillë Juridike:** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.